




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIK OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/GILAN BELEDIYESI / /MUNICIPAL GJILAN



Zyra komunale për kthim dhe komunitete

Raport intern

Zyra komunale për kthim dhe komunitete

KomunaGjilan

Raporti për periudhen Janar Qershor 2016

Raport gjashtmuor

1. Pozita dhe mandati i zyres komunale për kthim dhe komunitete sipas rregullores 2010/02

Zyra komunale për kthim dhe komunitete është formuar pas aprovimit të rregullores por edhe para saj zyret locale kanë funksionuar, është formuar sipas rekomandimeve të dhëna sipas rregullores 2010/02.

Në zyren për kthim dhe komunitete ka gjithsejt tetë punëtor ndersa sipas bugjetit ka pesë pozita .

Pozicionet dhe numri i punëtorëve ne Zyre:

- Shefi i Zyres për komunitete dhe kthim
- Kordinatori për kthim të qendrueshëm (pozicion i lire)
- Zyrtaret për kthim të qendrueshëm (dy punëtorë)
- Kordinatori për te drejtat dhe qështje të komuniteteve(një punëtor)
- Zyrtar për te drejtet dhe qështje të komuniteteve(dy punëtor)
- Zyrtar për komunitete dhe kthim (dy punëtor)

Rezyme e raportit

Në këtë raport janë përfshirë këto sfera:

- Procesi i Riatdhesimit
- Procesi i kthimit të qendrueshëm dhe
- Qështjet e komuniteteve

Në periudhën Janar-qershor 2016. ZKKK ka kryer këto aktivitete

Kthimi dhe kthimi i qëndrueshëm

- Nga fillimi I funksionimit dhe udhëheqjes së data-bazës në evidence i kemi 124 persona të cilët janë evidentuar si të kthyer,potencialisht të kthyer dhe përfitues potencial.
- Sipas evidences që posedon ZKKK nga 01.10.2016 deri më 31.06.2016 ikemi 24 kërkesa nga procesi I kthimit(kërkesa të komunitetit serb dhe rom).

Në periudhën raportuese lldhur me projektin EU-RRK IV janë mbajtur takime kordinuase dhe takime të task-forcës në të cilat janë shqyrtuar përfituesit potencial për përzgjedhje dhe asistim.

- Nga takimet me task-forcë janë mbajtur 7 takime.
- Në këtë process I kemi pasur 6 vizita nga tereni me akterët pëgjegjës në procesin e kthimit.
- Njena nga to shko-informo vizitë në Serbi e organizuar nga IOM-i.
- Është mbajtur një tkim nga grupi punues komunal.
- Në periudhën raportuese është miratuar ndertimi I tri shtepive për familje të kthyer.
- Përmes projektit BRICK-IOM janë ndihmuar dy familje (interrvenim i vogël deri në 3000 dollar).

Në periudhën raportuese kemi pasu takime me organizatën AT(Të pëparojmë s` bashku) e cila për here të parë vepron në komunën tone. AT organizata është partner implementuese I UNHCR-së . AT organizata ka ka mandate të njejt me vitet tjera ka pasur organizata KAAD dhe kjo është se bashkpunon me zyrtarët komunal që janë të angazhuar në procesin e kthimit, jep ndihmë teknike familjeve të kthyer ,regjistran familjet e kthyer ,monitoron(mbikqyr) dhe te tjera.

Procesi i Riintegrit të personave të riatdhesuar

Në periudhën 01.01.2016 deri më 30.06.2016 sipas Sistemit elektronik MPB me të cilën disponojmë janë kthyer nga vendet e treta janë kthyer 238 familje apo individ.

- Sipas evidences interene nga ZKKK janë lajmruar personalisht dhe evidentuar 103,nga procesi I riatdhesimit(familje apo individ)
- Nga procesi I riatdhesimit kemi pranuar 20 kërkesa të palëve .
- Në periudhën raportuese janë mbajtur tri takime të komisionit komunal për riintegrim-KKR dhe janë shqyrtuar 9 kërkesa të tyre dhe nga komisioni janë refuzuar te gjitha pasi që nuk I kanë prmbushur kriteret sipas rregullorës në fuqi.

- Me kordinatorin regional për riintegrim nga Zyra për Riintegrim jemi në kontakt të vazhdueshëm rreth procesit të riintegrit.

Sa I përket aktiviteteve të përditshme me të riatdhesuar kemi vrejtur se nuk janë të evidentuar në Sistemin elektronik-data-baza.

Sipas marveshtjës dhe në kordinim me Kryqin e Kuq në Gjilan të riatdhesuarit që kanë qëndruar ma teper se një vit ne vendet e treta drgohen perms palëve të dhënat dhe ata nese i plotësojnë kriteret socio-ekonomike marrin pako një muaj-pako ushqimore dhe higjienike nga Kryqi i Kuq.

- Qështjet e Komuniteteve

ZKKK ka marrë pjesë në pregatitjen e dhe vizitat në taren me pjestarët e komuniteteve pakicë të cilët kanë aplikuar nga programi I IOM-it nga programi për zhvillim ekonomik.Nga ky program I ndihmës gjithësejt kanë aplikuar 25 familje të komunitetit serb dhe rom.Të gjitha kerkesat janë në procedure të matutjeshme dhe selektim që dote bëhet nga ana e IOM-it.

Në kuader të aktiviteteve kemi pasur bashkpunim edhe me USAD-in lidhur me informatet e nevojshme.

Sa I perket komuniteteve kemi bashkpunuar me UNDP-n[për projektin”reagim I shpejt për stabilizimin e komuniteteve(faza e dytë)” të cilën e financon Zyra per qeshtje te komuniteteve dhe Zyra e kryeministrit e e njejta siguron innstrumente të nevojshme per qeshtje sociale dhe ekonomike te komuniteteve pakice, serb romashkali goran egjiptian etj.

Përfituesit e mundshëm do të mbshteten për zhvillim ose rritje të aktiviteteve të tyre punuese lidhur me:

- Prodhime bujqësore
- Përpunim dhe paketim të ushqimit

Konkursi ka pëfunduar më 10 Prill. Në këtë drejtim me përfaqshuesit e UNDP-së kemi organizuar prezentimin e programit. Ku kanë marrë pjesë të interesuarit e komuniteteve pakicë.

Të dhënat statistikore dhe përfituesit

Të dhënat statistikore nga qendra e data bazës nga MPB për individët dhe familjet nga procesi i riatdhesimit.

Në periudhën nga 01.01.2016 deri më 30.06.2016 në mënyrë tabelare janë paraqitur të dhënat sipas shteteve sipas numrit të familjeve ,anëtarve , dhe gjinisë.

Drzava	Gjiths. Sipas shteteve (individ dhe familje)	Individ	Familje	meshkuj	Femra	Fëmijë
Gjermani	176	131	45	139	64	101
FRANCa	12	7	5	10	6	5
Zvicra	19	18	1	18	2	2
Hungari	3	3	/	2	1	/
Suedi	11	10	1	6	6	1
Danimarkë	1	1	/	1	/	/
Norvegji	3	3	/	3	/	/
LUKSEMBURG	8	7	1	6	3	2
BELGJIKA	1	1	/	1	/	/
AUSTRIA	2	1	1	1	2	1
TURKIA	2	2	/	2	/	/
Gjithësejt	238	184	54	189	84	112

Nga numri i përgjithshëm i të riatdhesuarve në periudhën 01.01.2016.deri më 30.06.2016 në mënyrë tabelare është paraqitur numri i familjeve apo individve që janë kthyer vuulnetarisht ose me dhunë

	Familje	Individ	Gjithsejt
Vullnetarisht	35	49	84
Me dhunë	19	135	154
Gjithësejt	54	184	238

Milivoje Živković